



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 312/19
323/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi –Referues, z.Goran Milenković–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik N.N.P. “Arhiko.ing” –Prishtinë dhe OE “Taulant&StudioHapsira” SH.P.K., –Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i operatorëve ekonomik: “Eng Group” SH.P.K.&”Proart-Ing” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale” me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, më datën 05.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit N.N.P. “Arhiko.ing” –Prishtinë dhe ankesa e OE “Taulant&StudioHapsira” SH.P.K., – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan.

II. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik N.N.P.“Arhiko.ing” –Prishtinë dhe ankesa e OE “Taulant&StudioHapsira” SH.P.K., – Prishtinë,aprovohet pjesërisht si e bazuar,te dy OE ankues i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:22.03.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:06.05.2019

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dt: 27.05.2019

Njoftimi për tenderues të eliminuar / pasukseshëm dt: 27.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim nga OE“N.N.P.“Arhiko.ing” – Prishtinëdt:31.05.2019.

Kërkesa për rishqyrtim nga OE“Taulant&StudioHapsira”SH.P.K., – Prishtinëdt: 03.06.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën03.06.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar nga OE:“N.N.P.“Arhiko.ing” – Prishtinë, dhe me dt: 05.06.2019 Autoriteti Kontraktuesmarrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar nga“Taulant&StudioHapsira”SH.P.K., – Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues “N.N.P.“Arhiko.ing” – Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me13.06.2019me nr. 312/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Hartimi i projekteve detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, duke pretenduar se janë shkelur këto dispozita të LPP-së:

- Shkelje e nenit 7, 59, 65, 66, dhe 69 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- Nenin 3.12 dhe 33 të RrUOPP-së

Operatori ekonomik “Taulant&Studio Hapsira” SH.P.K., si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në

OSHP, me datë: 17.06.2019 me nr. 323/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, duke pretenduar se janë shkelur këto dispozita të LPP-së:

- Shkelje e nenit 7, 10, 24, 27, 56, 59, 60, 64, 67, dhe 69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.05.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertja Shqyrtuese në raportin e dt: 26.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “N.N.P. “Arhiko.ing” – Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1 Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar për arsye se njëra ndër arsyet e eliminimit të OE Ankues sipas AK është çmimi ofertues i OE është tendencioz dhe manipulues.

AK është dashur të veprojë në baze të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 3. Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

AK pa e përdorur këtë nen pa kërkuar sqarime nga Operatori ekonomik lidhur me çmimin e ofruar e ka eliminuar OE.

Përgjigje në pretendimin nr 2. Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për arsye se OE ankues e ka ofruar certifikatën ISO 193001:2011 i certifikuar sipas direktivës 2008/96/EC për inxh. të komunikacionit i cili e ka përfunduar me sukses trajnimin, mirëpo nuk e ka ofruar certifikatën

e aftësisë për auditues Inspektues të sigurisë rrugore. AK pa kërkuar sqarime shtese ashtu siç parashihet në Ligjin e prokurimit publik Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë e ka eliminuar edhe për këtë pike.

Përgjigje në pretendimin nr 3. Ky pretendim nuk është i bazuar për arsye se në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik” neni.33 përcakton rregullat e dorëzimit të tenderëve në mënyrë elektronike. Aty kërkohet që Formulari i shkarkuar nga sistemi të nënshkruhet me nënshkrim të avancuar digjital. Për më shumë thuhet: 33.9 Në rast se tenderi dorëzohet në emër të Grupit të Operatoreve Ekonomik, Formulari i Dorëzimit të Tenderit duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar, duke përdorur nënshkrimin e avancuar digjital. në emër të grupit” mirëpo një paragraf më poshtë thekson se (Nënshkrimi digjital i avancuar dhe koha e vulosjes së ofertës nga serveri nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP).

Përgjigje në pretendimin nr 4. Është i bazuar për arsye se AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar : 1 Inxh i komunikacionit me përvojë minimumi 10 vjet nga diplomimi sistemi 5 vjeçar apo master , Operatori ekonomik fitues nuk e plotëson këtë kriter për arsye se inxh i komunikacionit z, Korab Shehu studimet postdiplomike i ka përfunduar me datë 30.11.2011 që i bie se nuk i ka 10 vite përvojë pune nga diplomimi siç është kërkuar .


Përgjigje në pretendimin nr 5. Ky pretendim është i bazuar për arsye se AK në DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar h) Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi infrastrukturë rrugore, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 2 vjet përvojë pune nga diplomimi. Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës kërkohen që të jenë të Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës, me përvojë pune minimumi 2 vite nga diplomimi.

Operatori ekonomik fitues nuk e plotëson këtë kriter për arsye se z. Nuhi Nuhiu Inxh. ndërtimtarisë drejtimi infrastrukturë dhe rrugë me dt.26.04.2018 i është njohur grada Magjistër i ndërtimtarisë – Infrastruktura dhe rrugë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë .

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Taulant&StudioHapsira” SH.P.K. – Prishtinë.

Ky pretendim është pjesërisht i bazuar për arsye se AK në DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe /ose profesional ka kërkuar i) Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit (min.10 vjet përvojë nga diplomimi) sistemi 5 vjeçar apo master - auditor për siguri rrugore, në bazë të direktivës 2008/96/EC. ndërsa OE ankues e ka një inxhinier të ndërtimtarisë specialiteti i strukturës i cili është i certifikuar për auditor për siguri rrugore, në bazë të direktivës 2008/96/EC

Përgjigje ne pretendimin nr 2. Ky pretendimi është i bazuar sepse grupi i Operatoreve ekonomik “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”-Prishtine ne ofertën e tyre e kanë vendimin për caktimin e menaxherit te projektit.



Përgjigje ne pretendimin nr 3. Ky pretendim nuk është i bazuar sepse AK ka kërkuar: Për diplomat e fituara jashtë Republikës se Kosovës kërkohen që të jenë të Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës . Grupi i operatoreve ekonomik ankues nuk i kanë të nostrifikuara diplomat e stafit siç parashihet edhe ne Udhëzimit administrativ (MASHT) nr12 /2018 Parimet dhe Procedurat e njohjes se diplomave, gradave, dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës se Kosovës Neni 3 paragrafi 1 .Te gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale si dhe ato universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi do të nënshtrohen procedurave të njohjes/barasvlerës ne MASHT .

Përgjigje ne pretendimin nr 4.Ky pretendim nuk është i bazuar sepse Sigurimi i tenderit nuk është bere ne emër te Grupit te Operatoreve ekonomik apo ne emër te liderit te grupit por është bere nga kompania e dyte pjesëmarrëse ne grup .

Përgjigje ne pretendimin nr 5. Ky pretendim është i bazuar per arsye se AK ne DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar: Staf i Profesional a. Menaxheri i kontratës Nje inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 10 vjet provojë pune nga Diplomimi)
b. Një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, sistemi 5 vjeçar ose master (min.10 vjet provojë nga diplomimi)
c) Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 10

vjet provojë pune nga diplomimi.

OE fitues e ka një inxhinier të arkitekturës cili është i caktuar menaxher i kontratës, por i mungon edhe Një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës.

Përgjigje në pretendimin nr 6. Ky pretendim është i bazuar për arsye se AK në DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar h) Një Inxhinier të diplomuar të ndërtimitarisë - drejtimi infrastrukturë rrugore, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 2 vjet provojë pune nga diplomimi. Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës kohën që të jenë të Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës, me përvojë pune minimumi 2 vite nga diplomimi.

Operatori ekonomik fitues nuk e plotëson këtë kriter për arsye se z. Nuhi Nuhiu Inxhinier i ndërtimitarisë drejtimi infrastrukturë dhe rrugë me dt. 26.04.2018 i është njohur grada Magjistër i ndërtimitarisë – Infrastruktura dhe rrugë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë .

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankuuese “NNP ”Arhiko.Ing-Prishtine” dhe “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”- Prishtine të aprovohen pjesërisht si të bazuara (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e OE-ve), të anulohet Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**

Operatori ekonomik “N.N.P. “Arhiko.ing” – Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Operatori ekonomik OE ankuues “Taulant&StudioHapsira” SH.P.K., – Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorëve ekonomik ankuues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit të cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se pare ankuese. Sylajdeklaroj:Pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së se dytë ankuese. z. Halimideklaroj: Jemi pajtuar pjesërisht ne disa pika të raportit të ekspertës , ndërsa ne piken 2 te pretendimit nuk pajtohem ku kërkesa për auditor te certifikuar për siguri rrugore ne shtojce është kërkuar sqarimi poashtu ne anekse dhe ne sqarim e ka ngarkuar ne sistem Autoriteti Kontraktues per Auditor te certifikuar te sigurisë rrugore sipas direktivës 2008/96 EC ne shtojce plotësuese te ngarkuar e ka sqaruar qe te jete një ekspert i fushës dhe ne kemi plotësuar DT konform ati sqarimi ku kemi ofruar Auditorin e Certifikuar konform direktivës 2008/96, poashtu i kemi ofruar Licencat nga Ministria te zhvillimit urban poashtu edhe Certifikatën ne këtë rast është certifikata te cilën e japë si prove panelit, dhe konsiderojmë qe është konform DT-së te këtij AP.

Si pretendim tjetër si pjesërisht është sigurimi i tenderit, sigurimin e ka bere OE studio hapësira konform marrëveshjes se këtij konsorciumi, qe mund ti ofroj si prova. Tek pretendimi lidhur me nostrifikimin e Diplomave konsiderojmë se ky pretendim është ne kundërshtim me ligjin e LPP-së është diskriminues te cilin e kufizon pjesëmarrjen e gjere dhe ka te beje vetëm me individ te cilët kanë studiuar jashtë vendit dhe janë vendore por nuk e precizon për kompanitë ndërkombëtare. Për arsye se nostrifikimi kërkon një periudhe min 4 muaj ndërsa afatet e prokurimit janë 40 dite dhe kompanitë nga jashtë janë te kufizuara te marrin pjese, edhe kemi ndryshim ne DT ne 10 ditshin e fundit para se te mbyllet aktiviteti. Si prove do te jap për panelin UA MASHT 12/2018.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesjae AK-së znj. Sadikudeklaroj: Nuk pajtohem me mendimin e Ekspertes Shqyrtuese Pretendimet e OE “Arhiko.ing”: Komisioni nga ekspert nga fushat e ndryshme i caktuar për vlerësim te ofertave ka vlerësuar se çmimi i OE “Arhikoing” është çmim manipulues dhe tendencioz sepse çmimi i një projekti te trotuarit me ndriçim publik ne tregun tonë është nga 1.5 -2.5 për metër gjatësi kurse OE i renditur me radhe ka çmim për trotuare me ndriçim publik 8 euro qe kjo vlere e pa pranueshme dhe e papërbalueshme për Autoritetin Kontraktues ne pagesa, gjithashtu Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtese sepse çmimet e ofruara ne DT nuk mund te lëvizin dhe komisioni për vlerësim arsyeshëm e ka renditur këtë OE si te Eliminuar, për raste te tilla ne të kaluarën kemi pasur vërejtje nga Auditori i Përgjithshëm. Pretendimi 2-të është Kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë një inxhinier i diplomuar i Komunikacionit minimum 10 vite përvojë pune nga diplomimi, sistemi 5 vjeçar apo Master Auditor Për siguri Rrugore. Ne bazë te direktivës 2008/96 EC gjithashtu tek dëshmia ka qenë qe Autoriteti Kontraktues mbanë te drejtën e verifikimit te projekteve qe shënohen ne

CV, Diplomave dhe Certifikatave te kërkuara, Certifikata qe është bashkangjitur nga OE Arhikoing komisioni Vlerësues ka dyshuar qe kjo Certifikate është e falsifikuar dhe ne si Autoritet Kontraktues kemi kërkuar sqarime nga Trupat Certifikuese “KingCert” dhe ju është përgjigjur pyetjes sonë gjithashtu na ka dërguar edhe certifikatën origjinale te këtij inxhinieri dhe kur është bere krahasimi është vërejtur qe është intervenuar ne këtë Certifikate, do të thotë qe Certifikata Origjinal nuk i përmbush kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhe këtë mund ta vërtetoni shume lehte nëse e krahasoni një Certifikatë Origjinale me këtë qe ka ofruar OE ankues, siç shihet tek logo dhe drejtshkrimi i Certifikatës për Ing. Bekim Ahmeti si prove ia dorëzoj panelit shqyrtues.

Tek pretendimi i 4-të për Ing. te komunikacionit tek OE i propozuar për kontrate ka te bashkangjitur ne DT këtë Inxhinier me te gjithë Dokumentacionin si CV-ne, Referenca, dhe po i njëjti inxhinier ka përvojë pune pas diplomimit qe nga viti 2009. Tek pretendimi 5-të tek kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi Infrastruktura Rrugore, OE i propozuar për kontrate ka këtë Inxhinier qe i ka përfunduar studimet me 09.06.2016 dhe shihet qarte se ka 2 vite përvojë pune pas diplomimit nga data e njoftimit për kontrate, një sqarim shtesë rreth kësaj, askund ne kërkesat e Autoritetit Kontraktues ne DT apo njoftim për kontrate nuk ceket përvoja e punës qe kërkohet pas nostrifikimit te diplomës, përvoja kërkohet pas diplomimit kemi si prove dorëzojmë diplomën e z. Nuhi Nuhiut këtu ishin sa i përket OE “ArhikoIng”.

Ndërsa sa i përket pretendimeve te Grupit te OE “Taulant dhe Studio Hapsira”SH.P.K., fillimisht me duhet te ceke se ky konsorcium nuk ka pas qasje ne dokumente zyrtare dhe nuk ka pasur kërkesa për qasje dhe nuk e di ku i ka marr informacionet qe ka bërë këtë ankese përveç ato pretendime qe ka breë për vetveten. Tek pretendimi pare kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë një Inxhinier i diplomuar i Komunikacionit minimum 10 vite përvojë pune nga diplomimi sistemi 5 vjeçar apo master Auditor për Siguri rrugore, inxhinieri qe ka bashkangjitur OE ankues nuk është ne kërkesën e Autoritetit Kontraktues sepse ky OE ka bashkangjitur inxhinier te ndërtimtarisë specialist i strukturës. Tek pretendimi 5 Ky OE ka ne staf 2 inxhinier te arkitekturës mbi 10 vite përvojë pune poashtu ka të bashkangjitur edhe listat me te gjithë inxhinieret si ne kërkesë te Autoriteti Kontraktues këtu nuk jemi pajtuar as memendimin e ekspertes me këtë çështje sepse kemi 2 lista nga OE fitues është lista nga “Eng Grup” dhe lista nga “Pro Art” listat janë gjithashtu ne sistem ku shihet qe nuk mungon inxhinieri i diplomuar i Arkitekturës.

Gjatë prezantimit ne seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Doda deklaroi: Qëndroj prapa raportit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së parë ankuese deklaroi: Kërkojmë nga Paneli shqyrtues qe të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së dytë ankuese deklaroj: Kërkojmë nga Paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: kërkojmë të refuzohen të pa bazuara ankesat e OE-ve

Në vazhdim përfaqësuesi i “Arhiko.ing” deklaroj: Sa i përket kësaj është dashur të prezantohet në seance Burim Ramadani sepse ai e ka udhëheqë procedurën, sa i përket pretendimit të trotuarit ka qene çmimi i peshuar, ne e kemi plotësuar piken ku kërkohet për sekret afarist.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ne vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues “N.N.P. “Arhiko.ing” – Prishtinë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional lidhur me arsyen e eliminimit të OE Ankues ku sipas AK-së çmimi ofertues i OE ankues është tendencioz dhe manipulues.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se AK është dashur të veproje në baze të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 3. Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

AK pa e përdorur këtë nen pa kërkuar sqarime nga Operatori ekonomik lidhur me çmimin e ofruar e ka eliminuar OE.

Lidhur me pretendimin nr 2. Te OE ankues, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për arsye se OE ankues e ka ofruar certifikatën ISO 193001:2011 i certifikuar sipas direktivës 2008/96/EC për inxh. të komunikacionit i cili e ka përfunduar

me sukses trajnimin ,mirëpo nuk e ka ofruar certifikatën e aftësisë për auditues Inspektues te sigurisë rrugore. AK pa kërkuar sqarime shtese ashtu siç parashihet ne Ligjin e Prokurimit Publik, Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë e ka eliminuar edhe për këtë pike.

Lidhur me pretendimin nr. 3 te OE ankues, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar për arsye se në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik” neni. 33 përcakton rregullat e dorëzimit te tenderëve ne mënyrë elektronike. Aty kërkohet qe Formulari i shkarkuar nga sistemi te nënshkruhet me nënshkrim te avancuar digjital. Për me shume thuhet: 33.9 Ne rast se tenderi dorëzohet ne emër te Grupit te Operatoreve Ekonomik, Formulari i Dorëzimit te Tenderit duhet te nënshkruhet nga personi i autorizuar, duke përdorur nënshkrimin e avancuar digjital. ne emër te grupit” mirëpo një paragraf me poshtë thekson se (Nënshkrimi digjital i avancuar dhe koha e vulosjes se ofertës nga serveri nuk është i obligueshëm deri ne njoftim zyrtar nga KRPP).

Lidhur me pretendimin nr 4 te OE ankues Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton, se është i bazuar për arsye se AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar : 1 Inxh i komunikacionit me përvojë minimumi 10 vjet nga diplomimi sistemi 5 vjeçar apo master , Operatori ekonomik fitues nuk e plotëson këtë kriter për arsye se inxh i komunikacionit z, Korab Shehu studimet postdiplomike i ka përfunduar me date 30.11.2011 qe i bie se nuk i ka 10 vite përvojë pune nga diplomimi siç është kërkuar .

Lidhur me pretendimin nr 5 te OE ankues , Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton , se ky pretendim është i bazuar për arsye se AK ne DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar h) Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi infrastrukturë rrugore, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 2 vjet provojë pune nga diplomimi. Për diplomat e fituara jashtë Republikës se Kosovës kërkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës, me përvojë pune minimumi 2 vite nga diplomimi.

Operatori ekonomik fitues nuk e plotëson këtë kriter për arsye se z. Nuhi NuhiuInxh. ndërtimtarisë drejtimi infrastrukturë dhe rruge me dt. 26.04.2018 i është njohur grada Magjistër i ndërtimtarisë – Infrastrukture dhe rruge nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë .

Paneli shqyrtues ne vijim jep konstatimet ne lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues “Taulant&StudioHapsira” SH.P.K. – Prishtinë.

Lidhur me pretendimin nr. 1 te OE ankues, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton , se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për arsye se AK ne DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe /ose profesional ka kërkuar i) Një inxhinier i diplomuar i komunikacionit (min. 10 vjet provojë nga diplomimi) sistemi 5 vjeçar apo master - auditor për siguri rrugore, në bazë të direktivës 2008 96 EC. ndërsa OE ankues e ka një Inxhinier te ndërtimtarisë specialiteti i strukturës i cili është i certifikuar për auditor për siguri rrugore, në bazë të direktivës 2008 96 EC

Lidhur me pretendimin nr. 2 te OE ankues, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstatonky pretendimi është i bazuar sepse grupi i Operatoreve ekonomik “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”-Prishtine ne ofertën e tyre e kanë vendimin për caktimin e menaxherit te projektit.

Lidhur me pretendimin nr. 3 te ankuesit, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstatonky pretendim nuk është i bazuar sepse AK ka kërkuar: Për diplomat e fituara jashtë Republikës se Kosovës kërkohen qe te jenë te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës . Grupi i operatoreve ekonomik ankues nuk i kanë te nostrifikuara diplomat e stafit siç parashihet edhe ne Udhëzimit administrativ (MASHT) nr12 /2018 Parimet dhe Procedurat e njohjes se diplomave, gradave, dhe kualifikimeve te shkollave te larta profesionale dhe universitare te fituara jashtë Republikës se Kosovës Neni 3 paragrafi 1 .Te gjitha diplomat e shkollave te larta profesionale si dhe ato universitare te fituara jashtë vendit me qellim punësimi do ti nënshtrohen procedurave te njohjes/barasvlerës ne MASHT.

Lidhur me pretendimin nr. 4 te ankuesit, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton, se ky pretendim nuk është i bazuar sepse Sigurimi i tenderit nuk është bere ne emër te Grupit te Operatoreve ekonomik apo ne emër te liderit te grupit por është bere nga kompania e dyte pjesëmarrëse ne grup .

Lidhur me pretendimin nr. 5 te ankuesit, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton, se ky pretendim është i bazuar për arsye se AK ne DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar: Staf i Profesional a. Menaxheri i kontratës Nje inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 10 vjet provojë pune nga Diplomimi)

b. Një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 10 vjet provojë nga diplomimi)

c) Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 10 vjet provojë pune nga diplomimi.

OE fitues e ka një inxhinier te arkitekturës cili është i caktuar menaxher i kontratë, por i mungon edhe Një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës.

Lidhur me pretendimin nr 6 te ankuesit , Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton, se ky pretendim është i bazuar për arsye se AK ne DT dhe NJK tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar h) Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi infrastrukturë rrugore, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 2 vjet provojë pune nga diplomimi. Për diplomat e fituara jashtë Republikës se Kosovës kërkohej qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës, me përvojë pune minimumi 2 vite nga diplomimi.

Operatori ekonomik fitues nuk e plotëson këtë kriter për arsye se z. Nuhi Nuhiu Inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi infrastrukturë dhe rrugë me dt. 26.04.2018 i është njohur grada Magjistër i ndërtimtarisë – Infrastruktura dhe rruge nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë .

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe nenit 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna Lipjan
1x1 OE –N.N.P.“Arhikoing” – Prishtinë
1x1 OE–“Taulant&StudioHapsira” SH.P.K. – Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Blerim Dina

